



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 81

2003

Tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9137 datë 25.9.2003	Për një shtesë në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, i ndryshuar	3575
Ligj nr.9138 datë 25.9.2003	Për miratimin e aktit normative, me fuqinë e ligjit nr.2 datë 19.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fondit për partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore 2003	3575
Vendim i KM nr.609, datë 11.9.2003	Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “ROT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjitikës dhe shoqërisë “WONDER” sh.a për hidrocentralin e Bogovës	3576
Vendim i GJK nr.26, datë 1.10.2003	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues i vendimit të fazes së parë të pjesëtimit nr.874, datë 19.4.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ; vendimit nr.768, datë 21.6.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit përfundimtar nr.1818, datë 2.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimeve nr.803, datë 11.7.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1380, datë 26.12.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë	3585
Vendim i GJK nr.27, datë 1.10.2003	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr 217, datë 1.12.2002 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.189, datë 18.4.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë	3587

Udhëzim i MF
nr.2/1, datë 10.9.2003

Për një ndryshim në udhëzimin nr.2, datë 8.1.2003 “Për
sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë

3589

L I G J
Nr.9137, datë 25.9.2003

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7651, DATË 21.12.1992 “PËR FESTAT ZYRTARE E
DITËT PËRKUJTIMORE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, i ndryshuar, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:
“b/1. 19 Tetori - Dita e Lumturimit të Nënë Terezës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3973, datë 1.10.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9138, datë 25.9.2003

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.2, DATË 19.9.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR PARTITË POLITIKE,
PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET VENDORE, 2003”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 19.9.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fondit për partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore, 2003”.

Shpallur me dekretin nr.3974, datë 1.10.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.609, datë 11.9.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS "ROT"
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE TË
ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "WONDER", SHA PËR HIDROCENTRALIN E
BOGOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 9 e 10 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT" ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë "Wonder" sh.a. për hidrocentralin e Bogovës, në rrethin e Skraparit.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE KONCESIONI
PËR HIDROCENTRALIN BOGOVË-SKRAPAR

Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, të përfaqësuar ligjërisht nga z. Rozafat Shllaku për Ministrinë e Ekonomisë dhe z.Agim Bregasi për Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, më poshtë referuar si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)

dhe

shoqërisë "Wonder" sh.a.,Tiranë, përfaqësuar nga z. Vasil Gjika, më poshtë referuar si "Koncesionari".

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake,

Qeveria:

- konsideron privatizimin e sektorit elektroenergjetik si një mjet të rendësishëm të politikës energjetike dhe konfirmon një interes të lartë në privatizimin e hidrocentraleve vendore dhe atyre me fuqi të mesme, për të rehabilituar asetet publike të tyre (objektet dhe makineritë) që janë degraduar;

- vlerëson formulën e koncesionit ROT, sepse kjo bën të mundur rehabilitimin e hidrocentraleve pa prekur Buxhetin e Shtetit;

- mirëpret investitorët vendas në rehabilitimin, ruajtjen e aseteve dhe të kapaciteteve prodhuese të hidrocentraleve, si dhe fuqizimin e disa prej tyre;

- është e prirur për ngritjen dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike brenda vendit;

- autorizon, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.390, datë 12.6.2003 "Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion, në formën ROT të hidrocentralit Bogovë", Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, të negociojnë dhe të nënshkruajnë Marrëveshjen e koncesionit.

Koncesionari:

- është seriozisht i interesuar të investojë në fushën e elektroenergjetikës;

- ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për rehabilitimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit, objekt i koncesionit;
 - konsideron që iniciativa mund të bëhet e suksesshme në kushte të caktuara stabiliteti shoqëror-ekonomik;
 - është i aftë të rehabilitojë dhe të menaxhojë hidrocentralin "Bogovë" në Skrapar, objekt i koncesionit;
 - beson plotësisht se Qeveria do të mbështesë përpjekjen e Koncesionarit gjatë gjithë periudhës së koncesionit.
- Palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 1 **Përkufizime**

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ata do të kenë kuptimet përkatëse të shënuara si vijon:

Marrëveshja e koncesionit: Kjo Marrëveshje dhe anekset e saj.

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.

Koncesionari: Shoqëria "Wonder" sh.a., rruga "Lek Dukagjini", pallati përballë INIMA-s, Tiranë, president z. Vasil Gjika.

Shoqëri koncesionare: "Wonder Power" sh.a., e cila pas regjistrimit në gjykatë sipas përcaktimit në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, do të zhvillojë veprimtarinë koncesionare.

Hidrocentrali: Bogovë në rrethin e Skraparit me fuqi 2,5 MVA, që përcaktohet me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.390, datë 12.6.2003 "Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës "ROT" të hidrocentralit Bogovë".

Projekt: Studimi tekniko-ekonomik për rehabilitimin e hidrocentralit Bogovë në rrethin e Skraparit, në përputhje me formën "ROT" (rehabilitim-operim-transferim).

Fillimi i projektit: Janë veprimtaritë: marrja në dorëzim e hidrocentralit Bogovë, programi i rivënies në punë për të bërë të mundur fillimin e implementimit të projektit.

Lejet: Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet që Koncesionari mund t'ua kërkojë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e plotë të projektit, si dhe për stafin e vet gjatë gjithë periudhës koncesionare, në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kontratat: Të gjitha kontratat që mund të lidhen në të ardhmen nga Koncesionari.

Ndryshimet ligjore: Do të thotë çdo akt që ka karakter rregullator ose ligjor të miratuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë ose që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

ERE: Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

KESH sh.a.: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.

KKUjërave: Komiteti Kombëtar i Ujërave.

Neni 2 **Objekti i Marrëveshjes së koncesionit**

Objekt i kësaj Marrëveshjeje koncesioni është dhënia me koncesion i hidrocentralit Bogovë (Skrapar) së bashku me transformatorin ngritës 6/35 kV deri tek thika e tij nga ana e zbarave 35 kV, në përputhje me formën "ROT", me asetet që shënohen në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje dhe me genplanin.

Objektivat kryesore të këtij koncesioni do të jenë:

- rehabilitim i hidrocentralit duke e sjellë atë në kapacitetin e instaluar dhe prodhues, jo më të ulët se ai i projektit të zbatuar, në tërësinë fizike të objektit të dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje;
- operim optimal tekniko-ekonomik për prodhimin e energjisë elektrike;
- transferim shtetit, në mbarim të afatit të Marrëveshjes koncesionare, të tërësisë fizike dhe

aseteve të rehabilituara të objektit, në gjendje pune.

Neni 3

Kohëzgjatja e koncesionit

Marrëveshja e koncesionit për hidrocentralin Bogovë në Skrapar do të ketë një kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vjetësh duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e saj.

Neni 4

Detyrimet dhe të drejtat e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektivat e Marrëveshjes lidhur me termat dhe kushtet e saj.

Detyrimet e Koncesionarit:

- Të respektojë gjithë dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
 - Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje të formojë shoqërinë koncesionare dhe të bëjë regjistrimet e nevojshme për të lejuar këtë shoqëri të zhvillojë veprimtarinë e saj.
 - Të zbatojë programin e rehabilitimit të hidrocentralit, objekt i koncesionit, sipas anekseve 1, 2, 3 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje koncesioni.
 - Në hidrocentralin Bogovë do të investohen 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) euro në 2 (dy) vitet e parë.
 - Të marrë masa, me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë Marrëveshje dhe me cilësinë e kërkuar.
 - Të ruajë e të administrojë objektin e Marrëveshjes për prodhim të energjisë elektrike gjatë gjithë periudhës së koncesionit, si dhe ta shesë energjinë elektrike të prodhuar, në përputhje me specifikimet e kësaj Marrëveshjeje.
 - Të punësojë personelin aktual të hidrocentralit në koncesion duke mbajtur numrin e nevojshëm të tyre gjatë shfrytëzimit, duke respektuar marrëdhëniet e punës sipas legjislacionit në fuqi.
 - Në veprimtarinë e tij të respektojë legjislacionin në fuqi, në veçanti për fushën ku vepron, të respektojë ligjin për sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me licencën që do të jepet nga ERE.
 - Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
 - Të realizojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm gjatë kohëzgjatjes së koncesionit, edhe ndaj palëve të treta.
 - Në përfundim të afatit të koncesionit, Koncesionari është i detyruar t'i dorëzojë OSHA-së hidrocentralin në gjendje pune (përveç pasojave të forcave madhore) dhe me një rezervë të pjesëve të këmbimit për një vit.
 - Të respektojë detyrimet që rrjedhin nga ligjet e licencat gjatë ushtrimit të veprimtarisë koncesionare.
 - Të regjistrojë në ZRPP këtë Marrëveshje koncesioni.
- Të drejtat e Koncesionarit:
- Koncesionari gëzon të gjitha të drejtat e prodhuesit të energjisë elektrike sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Koncesionari ka të drejtë ekskluzive të ushtrisë veprimtarinë në sektorin e koncesionit për hidrocentralin Bogovë, në përputhje me licencën e operatorit prodhues të energjisë elektrike lëshuar nga ERE.

- Koncesionari nuk përgjigjet për asnjë detyrim që objektet e marra në koncesion kanë ndaj shtetit dhe të tretëve deri në hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA)

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) angazhohet të garantojë dhe të marrë përsipër detyrimet e mëposhtme:

- Të bashkëpunojë në mënyrë aktive për vërtetimin e gjendjes aktuale në të cilën ndodhet objekti i koncesionit, si dhe për dorëzimin e aseteve dhe të genplanit të tij.

- Të ndihmojë Koncesionarin për aplikimet, marrëveshjet ose kontratat e nevojshme për zbatimin e projektit, me institucionet e tjera (ERE, KK Ujërave, KESH).

- Të ndihmojë Koncesionarin në finalizimin e një Marrëveshjeje afatgjatë me KESH sh.a., për shitjen e energjisë elektrike, për aq kohë sa KESH sh.a. të jetë me kapital shtetëror.

- Të ndihmojë Koncesionarin, për nxjerrjen e të gjitha autorizimeve të nevojshme, lejeve të punimeve, lejeve të ndërtimeve dhe atyre të mbrojtjes së mjedisit, sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari pranë institucioneve përkatëse. Kërkesat do të jenë të përpiluara në formën ligjore të kërkuar nga ato institucione.

- Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi, që lidhet me pretendimet e personave fizikë dhe juridikë të ndryshëm për pronësinë e truallit nën objektin e dhënë në koncesion.

- Të ofrojë ndihmën e nevojshme për të organizuar sigurimin fizik të objekteve të koncesionit në përputhje me legjislacionin.

- Të ndihmojë Koncesionarin pranë çdo organi e autoriteti shqiptar për realizimin e projektit të tij dhe t'i garantojë Koncesionarit ekskluzivitetin për realizimin e projektit mbi objektin e dhënë në koncesion, gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

- Të ndihmojë Koncesionarin në zgjidhjen e problemit të përdorimit të ujit pranë Komitetit Kombëtar të Ujërave, në përputhje me legjislacionin.

- Të ndihmojë Koncesionarin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me KESH-in dhe institucione të tjera, pushtetin vendor etj.

- T'i dorëzojë Koncesionarit objektin e koncesionit, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

Investimet për rehabilitim në parametrat e projektuar, sipas projekteve teknike aneksi 2 dhe 3 janë shënuar në nenin 4 në vlerën 750 000 euro, por jo më pak se 675 000 euro.

Investimi i mësipërm mund të përbëjë një objekt për ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet dy palëve:

- sipas rezultateve të vërtetimit të gjendjes së hidrocentralit;

- në çdo kohë, gjatë zbatimit të projektit.

Neni 7

Shitja e energjisë

Sipas çmimit të shitjes së energjisë elektrike, të miratuar nga ERE, KESH sh.a. është i autorizuar të firmosë me Koncesionarin marrëveshje afatgjatë për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar, përsa kohë që KESH sh.a. do të jetë me kapital shtetëror.

Neni 8

Marrëdhëniet teknike me KESH sh.a.

Meqenëse pajisjet e komandimit dhe skema sekondare për nënstacionin 35/10 kV, që i përket KESH sh.a. ndodhen në sallën e komandës së hidrocentralit, personeli i hidrocentralit që i përket Koncesionarit nuk ka të drejtë të manovrojë në këto pajisje.

Mënyra e bashkëveprimit midis personelit të hidrocentralit dhe personelit të nënstacionit do të përcaktohet me një marrëveshje të posaçme ndërmjet Koncesionarit dhe KESH sh.a.

Neni 9

Puna, fuqia punëtore dhe riorganizimi i punës

Marrëdhëniet e punës, punësimi i personelit do të realizohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Programi i punimeve

Koncesionari detyrohet të rehabilitojë objektin sipas anekseve 2 dhe 3.

1. Koncesionari garanton aktivizimin e programit të rehabilitimit brenda një afati prej 60 ditësh, nga data e marrjes në dorëzim të objektit të koncesionit.

2. Koncesionari garanton të përfundojë investimin brenda afateve të shënuara në anekset 2 dhe 3.

3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje ndërmjet dy palëve.

4. Nëse Koncesionari largohet ose heq dorë nga koncesioni, investimet e kryera nga Koncesionari deri në këtë moment, mbeten pronë e OSHA-së, pa shpërblim.

Neni 11

Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit

OSHA ose Koncesionari mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje, nëse Pala tjetër nuk plotëson detyrimet e parashikuara në të.

Në rast të konfirmimit të çështjes për pretendimet e mundshme, Pala e dëmtuar do të njoftojë menjëherë për këto pretendime Palën tjetër, e cila brenda 30 ditëve duhet të japë një përgjigje argumentuese. Në bazë të kësaj përgjigjeje, Pala e dëmtuar do të gjykojë për të filluar ose jo procedurën për zgjidhjen e Marrëveshjes.

Neni 12

Marrëveshjet e aplikuara dhe kontratat

Duke iu referuar neneve 1, 4, 5, 9 dhe 22 të kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të zbatojë projektin duke përgatitur, diskutuar, përmbushur dhe firmosur, me mbështetjen e OSHA-së, të gjitha aplikimet, marrëveshjet dhe kontratat.

Koncesionari, për të përmbushur detyrimet e Marrëveshjes së koncesionit, është gjithashtu i autorizuar të nënshkruajë marrëveshje nënkontraktore me palë të tjera për rehabilitimin e hidrocentraleve sipas projektit.

Koncesionari do të ketë përgjegjësi ndaj OSHA-së për të gjitha punimet për rehabilitimin e hidrocentralit.

OSHA nuk ka përgjegjësi kundrejt palëve të treta, punëtorëve apo sipërmarrësve që kanë lidhje me Koncesionarin, përveç detyrimeve që OSHA ka marrë përsipër në këtë Marrëveshje.

Neni 13

Riparimi dhe mirëmbajtja

Koncesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha llojet e riparimeve dhe mirëmbajtjeve në objektet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 14

Kontrolli i përgjithshëm

OSHA mund të ushtrojë një kontroll të përgjithshëm gjatë operacioneve të rehabilitimit dhe të përgatitjes për punë, nëpërmjet të autorizuarve në marrëveshje të përbashkët midis Koncesionarit dhe OSHA-së, me qëllim që të verifikojë nëse punimet janë në përputhje me programin e rehabilitimit dhe dokumentacionin e projektit.

Në rast të shkeljeve të Marrëveshjes, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari

do të njoftohet me shkrim dhe do të vërë në zbatim masat e nevojshme për të ardhmen, në rast të kundërt ky rast mund të shërbejë si bazë për zgjidhjen e Marrëveshjes sipas përcaktimeve të nenit 10 të saj.

Neni 15

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 16

Forca madhore dhe të paparashikuara

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, ngjarjet e jashtëzakonshme politike, lufta (dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit) dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj Marrëveshjeje (mosfurnizimi me ujë i hidrocentralit nga faktorë subjektivë), duke e bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e Palëve.

Palët nuk do të jenë përgjegjëse, nëse nuk arrijnë detyrimet e tyre në këtë Marrëveshje, si rezultat i ndikimit të forcës madhore.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të priset ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër duke i treguar dhe duke arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Nëse gjatë zbatimit të Marrëveshjes do të ketë veprim të forcave madhore, atëherë Palët mund të mos zbatojnë detyrimet e tyre; në këtë rast nuk do të kërkohet kompensim reciprok nga Palët.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të konfirmohen nga Palët në një procesverbal të ngjarjes.

Si rrjedhim i ngjarjeve të shkaktuara nga një forcë madhore, kohëzgjatja e koncesionit do të shtyhet për një periudhë kohe, që caktohet me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

Neni 17

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së koncesionit

Marrëveshja e koncesionit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike" me ndryshimet përkatëse.

Neni 18

Marrja në dorëzim e hidrocentralit

Pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave, marrja në dorëzim e hidrocentralit në koncesion do të bëhet brenda 15 ditëve.

Neni 19

Klauzola të përgjithshme

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjithë dokumentacionin është bërë në gjuhën shqipe dhe është hartuar në 7 (shtatë) kopje origjinale, 5 (pesë) prej të cilave do të merren nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe 2 (dy) kopje do të merren nga Koncesionari.

Neni 20

Zbatimi i projektit

Çdo muaj Koncesionari është i detyruar të raportojë me shkrim pranë OSHA-së, realizimin e

programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Në përfundim të zbatimit të projektit rehabilitues mbi objektin e koncesionit, do të hartohet një dokument përfundimtar në të cilin do të konfirmohet se shoqëria ka përmbushur detyrimet e saj për rahabilitim, sipas kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve, që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk do të anulohen detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Marrëveshje, si shkeljet, anulimi ose pavlerëshmëria e saj, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 22

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizojnë Palët sipas një vendimi të gjykatës së mësipërme.

Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 10 pika 1, Koncesionari do t'i paguajë OSHA-së për çdo ditëvonesë penaltetin 0,01% të vlerës së investimit të përealizuar për çdo program rehabilitimi.

Neni 23

Bashkëpunimi ndërmjet OSHA-së dhe Koncesionarit

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë, në mënyrë që të garantojnë zbatimin e projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresat e mëposhtme:

OSHA
Ministria e Ekonomisë
Bulevardi "Zhan d'Ark" nr.2
Tiranë

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës
Sheshi Skënderbej nr.2
Tiranë

Koncesionari:
Rruga "Lek Dukagjini", pallati përballë INIMA-s,
Tiranë
President: Vasil Gjika

Mobile: 00355 69 20 20468
69 20 91069
Tel/fax: 00355 4 268 240
4 258 931

Palët kanë pranuar këtë Marrëveshje duke nënshkruar si më poshtë:

Për Ministrinë e Ekonomisë
z.Rozafat Shllaku

Për shoqërinë "Wonder" sh.a.
z.Vasil Gjika

Për Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës
z.Agim Bregasi

**INVENTARI I PRONËS SË PALUAJTSHME SHITETËRORE PËR HIDROCENTRALIN E
BOGOVËS NË RRETHIN E SKRAPARIT**

Nr.	Komponentët	Përmasat në m2 ose ml	Funksioni
1.	Ndërtesa	313 m2	Ku janë instaluar makineri e pajisje për prodhimin e energjisë elektrike
2.	Prita e marrjes		Marrje uji
3.	Kanali i derivacionit	3000 ml	Përcjellje uji
4.	Baseni i presionit	500 ml	Mbajtje uji
5.	Tubacioni i presionit	250 ml	Dërgim uji në turbinë
6.	Fjetore punëtorësh	74 m2	

Shënim: Ky inventar është marrë nga dokumenti "Inventari i pasurive të paluajtshme të KESH sh.a.", sjellë nga KESH sh.a. në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës me shkresën nr.4694, datë 13.6.2003.

Aneksi 2

PROGRAMI I REHABILITIMIT TË HECIT BOGOVË

Fuqia e instaluar	Investimet në euro		Investime gjithsej	Prodhim i energjisë në 000/kw			
	Viti i parë 2003-2004	Viti i dytë 2004-2005		2003-2004	2004-2005	2005-2006	2006
2500 KW	435 000	315 000	750 000	2900	4160	4700	5200

Aneksi 3

INVESTIMET PËR REHABILITIM

Hidrocentrali Bogovë, rrethi Skrapar

Emërtimi	Vlera në euro		Normat e projektimit dhe zbatimit që aplikohen
	Viti 1	Viti 2	
Punime ndërtimi: Rehabilitim dhe h/izolime në rezervuar, riparime në kanalin kryesor, pastrim dhe murëmbajtës për mbrojtjen e objektit nga përroi Bogovë, sistemime në basen, drosela, central dhe në bjefin e poshtëm	100 000	80 000	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.444, dt.5.9.1955, KTP, KTZ. Manualët e preventivimit
Punime hidromekanike: Rehabilitim e zëvendësime në turbinë dhe gjenerator, aftësim i sistemit të ftohjes ujë ajër, rinovim i rregullatorit të shpejtësisë dhe grupit hidraulik, drosela, tubacioni i marrjes, porta kryesore e rezervuarit etj.	150 000	100 000	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.444, dt.5.9.1995 KTP, KTZ. Manualët e preventivimit

Punime elektrike: Ekzistuesi dhe rregullatori i ri i tensionit (AVR), mbrojtje e gjeneratorit dhe e linjave, pajisje e re e sinkronizimit, rinovime në sistemin AC, DC etj.	80 000	70 000	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.444, dt.5.9.1995 KTP KTZ Manualet e preventivimit
Rinovim i supervizimit e kontrollit: sistemi qendror, lokal, rrjeti dhe instalimi i tij (hardware); sistemi operativ, programi aplikativ (software); kabllimi; pajisjet e integruara matëse; matrica e mbrojtjes së shpejtë.	70 000	30 000	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.444, dt.5.9.1995 KTP, KTZ Manualet e preventivimit
Trajnim: Njohja e teknologjisë që do të investohet nga personeli, kualifikimi pranë njësive të specializuara në KESH sh.a., kualifikimi në firmat ku do të blihet teknologjia	10 000	10 000	Manuale e rregullore teknike dhe të shfrytëzimit
Pjesë këmbimi: Planifikuar sipas listës së rezervave të furniturave për makineri e pajisje	25 000	25 000	Rregullore teknike dhe të sigurimit teknik
Total investimi për rehabilitim	750 000 Euro		

V E N D I M
Nr.26, datë 1.10.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci Anëtar i “““
Gjergj Sauli Anëtar i “““
Alfred Karamuço Anëtar i “““
Kujtim Puto Anëtar i “““
Kristofor Peçi Anëtar i “““
Xhezair Zaganjori Anëtar i “““
Petril Plloçi Anëtar i “““
Sokol Sadushi Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 7.7.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti që i përket:

KËRKUES: BEQIR TURTULLI, përfaqësuar nga avokatët Hanëme Bakia e Skënder Kaçupi, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: VOJSAVA KRUJA

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit të fazës së parë të pjesëtimit nr.874, datë 19.4.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimit nr.768, datë 21.06.2001 të Gjykatës së

Apelit Tiranë; vendimit përfundimtar nr.1818, datë 2.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimeve nr.803, datë 11.7.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1380, datë 26.12.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se të gjitha vendimet e sipërcituara janë antikushtetuese për arsye të zhvillimit të një gjykimi të parregullt, duke parashtruar këto shkaqe kryesore për shfuqizimin e tyre:

Së pari, padia është pranuar në kundërshtim me rregullat procedurale (nenet 154, 155, 156 të Kodit të Procedurës Civile). Ajo nuk është shoqëruar me prova; kopja e kërkesëpadisë nuk i është komunikuar të paditurit; nuk është paguar vlera e padisë. Në këto kushte, gjykata duhej t'ia kthente padinë paditësit. Kjo vërteton njëanshmërinë dhe mungesën e objektivitetit në gjykim.

Së dyti, gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit është zhvilluar në mungesë. Seancat e datës 30.3.2000, 12.4.2000 dhe 19.4.2000 janë zhvilluar pa njoftuar të paditurin, duke pasqyruar në procesverbal shënimin se është marrë vendimi i gjykimit në mungesë. (Ka shkelur nenet 33/1 e 42/2 të Kushtetutës dhe nenet 18, 19, 20, 179 të Kodit të Procedurës Civile).

Së treti, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë janë ngritur shkaqe ligjore, por që kolegji, në dhomën e këshillimit, padrejtësisht nuk i ka vlerësuar si të tilla. (Një ndër shkaqet është se gjykatat nuk kanë respektuar praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhur me përjashtimin e sendeve të fituara në rrugë trashëgimie nga pjesëtimi i pasurisë).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuarit, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.874, datë 19.4.2000 ka vendosur pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore nga ½ pjesë secili. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.768, datë 21.6.2001.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.1818, datë 2.5.2002 ka urdhëruar ndarjen në natyrë të sendeve, vendim ky që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.803, datë 11.7.2002. Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese çmon se pavarësisht nga pretendimet që ka parashtruar kërkuari për mënyrën e zgjidhjes në thelb të çështjes, lidhur me pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, nuk është detyrë e saj të vlerësojë drejtësinë e këtyre vendimeve gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese nuk analizon të gjitha shkeljet procedurale apo materiale që mund të kenë ndodhur në një proces gjyqësor, por vetëm shkeljet kryesore që kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Pretendimet e kërkuarit mbi mënyrën e përpilimit të kërkesëpadisë, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykatat e zakonshme dhe nuk janë shkelje që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me parimet esenciale të procesit të rregullt ligjor. Nga përfaqësuesit e kërkuarit nuk argumentohet se në cilin drejtim shkeljet e rregullave procedurale të depozitimit të kërkesëpadisë prekin konceptin kushtetues të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

Pretendimi tjetër për zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuarit nuk rezulton të jetë i bazuar. Gjykata e rrethit gjatë zhvillimit të fazës së parë të pjesëtimit ka njoftuar kërkuarin, me cilësinë e palës së paditur në proces, duke zbatuar dispozitat procedurale që lidhen me njoftimin. Gjykata, pasi ka shqyrtuar seancën gjyqësore katër herë radhazi, në seancën e datës 30.3.2000 ka marrë vendimin për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Në fletëthirrjen që i korrespondon kësaj date të gjykimit rezulton se në prani të dy personave kërkuari ka refuzuar nënshkrimin. Në këto kushte, gjykata nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të vazhduar gjykimin në mungesë të palës së paditur.

Përsa i përket vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të marrë në Dhomën e Këshillimit, Gjykata Kushtetuese duke iu referuar qëndrimin të saj të konsoliduar, çmon se nuk është e mjaftueshme për të kërkuar antikushtetueshmërinë e vendimit gjyqësor vetëm paraqitja e shkaqeve

ligjore në rekurs, por është e domosdoshme që këto pretendime të gjejnë pasqyrim në dosje dhe të kenë lidhje të drejtpërdrejt me elementet thelbësore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Nga dosja rezulton se shkaqet e parashtruara në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ishin të lidhura kryesisht me fazën e parë të pjesëtimit, ndërkohë që objekti i rekursit ishte kundërshtimi i vendimit të fazës së dytë të pjesëtimit.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuarit nuk përfshihen në konceptin kushtetues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr.27, datë 1.10.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i““““

Gjergj Sauli Anëtar i““““

Kristofor Peçi Anëtar i““““

Kujtim Puto Anëtar i““““

Petrit Plloçi Anëtar i““““

Sokol Sadushi Anëtar i““““

Xhezair Zaganjori Anëtar i““““

Alfred Karamuço Anëtar i““““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 7.7.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti që i përket:

KËRKUES: LUAN SULAJ përfaqësuar nga avokat Kastriot Brahim Muço, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Saliko Hajno, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.217, datë 1.12.2002 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.189, datë 18.4.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme, kërkuar ka parashtruar këto shkaqe:

- Gjykimi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe vendimi i marrë janë të njëanshëm dhe të pavlefshëm sepse kryesuese e seancës dhe relatore e çështjes ka qenë një gjyqtare që ka marrë pjesë në

seancën gjyqësore të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë për sigurim të provës.

- Gjykata e Lartë nuk e konsideron shkak për shqyrtimin e çështjes shkeljen e mësipërme, si dhe faktin që në gjykimin në shkallë të parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, akuzën e ka përfaqësuar një prokuror i Prokurorisë së Rrethit Fier, pa pasur autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuarit të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.166, datë 10.6.2002 ka deklaruar fajtor Luan Sulën për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit, parashikuar nga neni 114/1 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 11 muaj burgim. Paraprakisht, në fazën e hetimit, me kërkesën e prokurorit të rrethit Fier, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka zhvilluar një seancë e ka marrë vendim për sigurim prove, pyetjen me cilësinë e dëshmitares të të dëmtuarës Ilva Çelaj. Më pas në një seancë tjetër, kur është marrë prova, në trupin gjykues ka qenë gjyqtarja Meme Rexho.

Mbi ankimin e prokurorit të rrethit Fier, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.217, datë 1.12.2002, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe duke gjykuar çështjen në fakt ka deklaruar të pandehurin fajtor për shfrytëzim të prostitucionit në rrethana rënduese dhe në bazë të nenit 114/2 të Kodit Penal e ka dënuar me 7 vjet burgim. Në këtë seancë, kryesuese dhe relatore e çështjes ka qenë gjyqtarja Meme Rexho.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.189, datë 18.4.2003, nuk ka kaluar për shqyrtim gjyqësor rekursin e të pandehurit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se kërkesa duhet rrëzuar për shkak se në gjykimet dhe vendimet e kontestuara nuk gjenden elemente të gjykimit të parregullt në kuptimin kushtetues, në mbështetje të nenit 42/1 dhe 131/f të Kushtetutës.

Nga përmbajtja e nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale, del se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vlerësuar çdo kërkesë të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak. Duke iu referuar nenit 320 (disponimi mbi kërkesën për sigurimin e provës) dhe nenit 321 (marrja e provës), del se midis tyre ka një ndryshim thelbësor. Në rastin e parë, gjykata disponon me vendim, duke vlerësuar nëse duhet marrë ose jo prova e kërkuar, kurse veprimi i kryer sipas nenit 321 për marrjen e provës përbën një procedurë të thjeshtë e të domosdoshme pa u investuar gjykata me asnjë lloj vlerësimi.

Nga shqyrtimi i çështjes objekt kërkesë, rezulton se kërkesën për sigurimin e provës e ka vlerësuar dhe ka marrë vendimin përkatës një gjyqtare tjetër, kurse Meme Rexho ka marrë pjesë në trupin gjykues kur është dëgjuar dëshmitarja, procedurë në të cilën nuk bëhet vlerësim i provës e as merret ndonjë vendim. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se pjesëmarrja e gjyqtarës në seancën e marrjes së provës, nuk mund të influenconte në krijimin e bindjes në marrjen e vendimit nga Gjykata e Apelit Vlorë. Janë këto arsye që pjesëmarrja e gjyqtarës Meme Rexho në gjykimin në shkallën e dytë nuk përbën rast të papajtueshmërisë, parashikuar nga neni 15 i Kodit të Procedurës Penale e as shkak njëanshmërie që do ta bënin gjykimin në gjykatën e apelit të parregullt dhe vendimet e cenueshme.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, nuk gjen elemente të procesit të parregullt gjyqësor as në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përse pretendon kërkuari.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

U D H Ë Z I M
Nr.2/1, datë 10.9.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 8.1.2003 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave

U D H Ë Z O N:

1. Paragrafi i pestë i pikës 21 të udhëzimit nr.2, datë 8.1.2003 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshon si më poshtë:

"Mbitaksa për importet e taksueshme dhe taksa mbi konsumin e karburantit për gazoilin, benzinën dhe benzolin, janë taksa ekstra, që nuk do të përfshihen në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes së taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës".

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCËS
Kastriot Islami

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Civil <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003

Doli nga shtypi më 2.10.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 50 lekë